



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/47

Datë: 09.11.2011

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, me qëllim të zbatimit të Ligjit nr. 02/L-37 për përdorimin e gjuhëve, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 9 nëntor 2011, mori:

V E N D I M

1. Themelohet Grupit Punues për reformimin e Komisionit qeveritar të Gjuhëve dhe krijimin e politikave të përdorimit të gjuhëve në Republikën e Kosovës, i cili udhëhiqet nga Zëvendëskryeministri i Kosovës dhe Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal z. Slobodan Petrovic.
2. Grupi Punues ka këtë përbërje:
 - 2.1. Srdjan Popovic -Këshilltar i Kryeministrit-Drejtor i Zyrës për Çështje të Komuniteteve-ZKM;
 - 2.2. Besim Kajtazi, Drejtor i Zyrës Ligjore-ZKM;
 - 2.3. Përfaqësues i Këshillit Konsultativ për Komunitete;
 - 2.4. Fehmi Stublla -Kryetar i Komisionit për Gjuhët;
 - 2.5. Qemajl Marmullakaj - Zyra për Planifikim Strategjik-ZKM;
 - 2.6. Përfaqësues i Ministrisë së Administratës Publike;
 - 2.7. Përfaqësues i Ministrisë së Administrimit të Administrimit të Pushtetit Lokal;
 - 2.8. Përfaqësues i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë;
 - 2.9. Përfaqësues i Ministrisë për Komunitete dhe Kthim.
3. Në cilësinë e ekspertëve dhe ndihmës së jashtme ftohen:
 - 3.1. Maurizio Montipó - Community Rights Advisor PCN (ICO);
 - 3.2. Georg Eckborg - OSBE (OSCE):

- 3.3. Përfaqësues i Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë;
 - 3.4. Përfaqësues i Ambasadës së Zvicrës në Kosovë;
 - 3.5. Përfaqësues i Ambasadës së Norvegjisë në Kosovë;
 - 3.6. Përfaqësues i ECLO;
 - 3.7. Përfaqësues i UNDP;
 - 3.8. Përfaqësues i ECMI.
4. Grupi Punues do të zhvillojë dhe paraqesë para Qeverisë për miratim, më së largu tre muaj pas themelimit, masat, aktet përkatëse ligjore dhe procedurat e nevojshme për reformim, forcimin dhe ngritjen e kapacitetit dhe efikasitetit për Komisionin për Gjuhët, me qëllim të ngritjes së efikasitetit të zbatimit të Ligjit për përdorimin e gjuhëve.
 5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THACI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm në ZKM
- Arkivit të Qeverisë